



## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) dhe në pajtim me nenin 20, paragrafi (2) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

### **V E N D I M** **për ndryshim të** **Vendimit të rezervës së detyruar**

1. Në Vendimin e rezervës së detyruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 16/23), në pikën 6), paragrafi (1), nënparagrafi (2) përqindja: "50%" zëvendësohet me përqindjen: "100%".

Në nënparagrafin (3), përqindja: "19%" zëvendësohet me përqindjen: "20%".

2. Pika 8) ndryshon dhe bëhet:

"Rezerva e detyruar e bankave në denarë llogaritet si mbledhje e:

- shumës së fituar nga zbatimi i normave nga pika 6), paragrafi (1), nënparagrafi (1), dhe paragrafi (3) i këtij vendimi mbi bazën e detyrimeve në valutën vendase; dhe
- 20% e shumës së fituar nga zbatimi i normave të pikës 6), paragrafi (1), nënparagrafi (3), paragrafi (2) dhe paragrafi (3), nënparagrafët (2) dhe (5) të këtij vendimi, mbi bazën e detyrimeve në valutë të huaj."

3. Pika 9) ndryshon dhe bëhet:

"Rezerva e detyruar e bankave në valutë të huaj llogaritet si mbledhje e:

- 80% e shumës së fituar nga zbatimi i normave nga pika 6), paragrafi (1), nënparagrafi (3), paragrafi (2) dhe paragrafi (3), nënparagrafët (2) dhe (5) të këtij vendimi mbi bazën e detyrimeve në valutë të huaj; dhe
- shumës së fituar nga zbatimi i normave nga pika 6), paragrafi (1), nënparagrafi (2) dhe paragrafi (3), nënparagrafët (2) dhe (5) të këtij vendimi mbi bazën e detyrimeve në valutë vendase me klauzolë valutore".

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do të fillojë të zbatohet nga 1 nëntori 2023, me mbajtjen e rezervës së detyrueshme të llogaritur nga detyrimet e shtatorit 2023.

**Nr. 02 –27127/2**  
**1 gusht 2023**  
**Shkup**

**Guvernatorja**  
**dhe kryesuesja**  
**e Këshillit të Bankës Popullore të**  
**Republikës së Maqedonisë së Veriut**  
**dr. Anita Angellovska-Bezhoska**